

Projekti “MODERNIZIMI I SISTEMIT SHENDETESOR SHQIPTAR”

1.1 Donatori

Projekti i tretë i Bankës Botërore, i financuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) si dhe me bashkëfinancim nga Qeveria Japoneze në formën e një granti.

1.2 Kosto Totale e Projektit

Kostoja e përgjithshme e këtij projekti është përlogaritur të jetë afërsisht 17 milion USD.

1.3 Statusi

- a) Në zbatim

1.4 Kohëzgjatja

- a) Data e Fillimit të Zbatimit
- b) Data e Mbarimit

1.5 Institucioni Kryesor përfitues

Ministria e Shëndetësisë

1.6 Institucioni Partner përfitues

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
Instituti i Shëndetit Publik
Institucionet spitalore

1.7 Objektivi i Projektit

Objektivat kryesorë të këtij projekti janë:

- (i) përmirësimi i aksesit fizik dhe financiar si dhe përdorimi i shërbimeve shëndetësore parësore të cilësisë së lartë;
- (ii) përmirësimi i kapaciteteve kombëtare për të formuluar, zbatuar politika dhe reforma shëndetësore në sektorin e shëndetësisë si dhe
- (iii) përmirësimi i administrimit dhe menaxhimit të spitaleve

1.8 Aktivitetet e parashikuara në kuadër të këtij projekti

Ndërtimi i kapaciteteve për sigurimin e shërbimeve shëndetësore në Institutin e Sigurimeve Shëndetësore si dhe në Institutin e Shëndetit Publik do të përfshijë aktivitete të tilla si:

- zhvillimi i metodave të pagesës dhe kontraktimit ndërmjet blerësit dhe ofruesit të shërbimeve shëndetësore;
- zhvillimi dhe monitorimi i politikave dhe strategjive shëndetësore për MSH dhe ISHP;
- krijimi dhe menaxhimi i sistemeve shëndetësore të informacionit;
- krijimi i një sistemi monitorimi të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- përgatitja e standarteve për licencimin e punonjësve të shëndetësisë dhe spitaleve;
- zhvillimi i kapaciteteve për vlerësimin e teknologjive shëndetësore si dhe përgatitja

- e standarteve për pajisjet dhe mbështetjen e sistemeve spitalore;
- ndërtimi i kapaciteteve në MSH për zbatimin dhe administrimin e këtij projekti.

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore të kujdesit parësor

- lehtësimi i procesit të regjistrimit të popullsisë për të marrë shërbime shëndetësore të kujdesit parësor;
- ndërtimi i kapaciteteve të menaxhimit pranë këtyre shërbimeve (3) përgatitja e Guidave Klinike;
- krijimi i sistemit të edukimit të vazhdueshëm mjekësor;
- zhvillimi i programeve të trainimit për mjekët;
- sigurimi i pajisjeve bazë shëndetësore për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor;
- organizimi i fushatave të informacionit publik për të nxitur regjistrimin e përfitueseve të shërbimeve.

Përmirësimi i menaxhimit dhe administrimit të spitaleve do të synojë ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të spitaleve nëpërmjet:

- forcimit të menaxhimit financiar, menaxhimit të përgjithshëm dhe kapacitetit të prokurimit në spitale;
- zhvillimit të një kuadri rregullator, duke përfshirë urdhëresa dhe rregullore për të lehtësuar ndryshimin e statusit të spitaleve në ente autonome publike dhe zhvillimi i një strategjie spitalore racionalizimi si dhe
- testimit të një modeli pilot për autonominë të spitaleve.